REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE MJEDISIT

Nr. 7958 Prot. Lushnjë 14/08/2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
(këtu)

"PËR MIRATIMIN E INVESTIMIT ME OBJEKT: RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE FOTO PUKA)"

Të nderuar këshilltare/ këshilltarë

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës arsimore dhe krijimin e kushteve bashkëkohore për zhvillimin e procesit mësimor parashikohet ndërhyrja në rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare Foto Puka.

Godina e shkollës Foto Puka si pasojë e viteve të përdorimit dhe amortizimit natyror, paraqet një sërë problematikash që ndikojnë në funksionalitetin e saj. Nga vlerësimet teknike rezulton se objekti ka nevojë për ndërhyrje rikonstruksioni në elementët arkitektonikë dhe instalimet inxhinierike, me qëllim përmbushjen e standarteve teknike dhe funksionale të kërkuara për institucionet arsimore.

Kjo ndërhyrje parashikon rehabilitimin e ambienteve të brendshme (suvatime, lyerje, dysheme, dyer dritare) , rifiniturave të jashtme të fasadave, rehabilitimin e sistemit të largimit të ujërave të shiut, rikonstruksionin e nyjeve sanitare, rrjetit elektrik, përmirësimin e sistemit të ngrohjes, punime për mbrojtjen nga zjarri, sistemi i monitorimit me kamera, sistemimin e ambienteve të jashtme me terrene sportive dhe elementëve funksionalë të oborrit të shkollës.

Ndërhyrja është dhe si kërkesë e bordit të prindërve dhe stafit arsimor në dëgjesat e buxhetit të vitit 2026 të zhvilluara gjatë muajit nëntor 2025.
Kjo ndërhyrje parashikohet të financohet nga fondi "Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, me cikël financimi2026-2028, nga programet "Arsimi Bazë" dhe Arsimi Mesëm" për infrastrukturën shkollore miratuar me Urdhërin Nr. 382, datë 20/07/2026 dhe Bashkia Lushnjë sipas tabelës së mëposhtme:

Viti i parashikuar		**2026**	**2027**
Vlera totale e investimit	86,446,502.00 lekë		
Financimi nga MAS	69,157,202.00 lekë	42,662,880.00 lekë	26,494,322.00 lekë
Bashkëfinancimi nga Bashkia Lushnjë	17,289,300.00 lekë	10,000,000.00 lekë	7,289,300.00 lekë

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Të Territorit
Ing. Ariola Beqo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJË

Nr 7958/1 Prot. Lushnjë, më 14.08.2026

PROJEKT- VENDIM

NR. 69 DATË 14 / 08 /2026

"PËR MIRATIMIN E INVESTIMIT ME OBJEKT: RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS 9 – VJEÇARE 'FOTO PUKA"

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës ___.___.2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë, në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 shkronja "b", pika 1.6 shkronja "a ", neni 23 pika 4 të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar. Neni 1 shkronja "b", neni 4 pika 1, neni 12 pika 1 të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit " i përditësuar . Neni 4 pika 4, neni 6 shkronja "b", neni 7 pika 1 të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" Ju:

PROPOZOJMË

1. Miratimin e investimit me objekt: Rikonstruksioni i shkollës 9 – vjeçare "Foto Puka".
2. Miratimin e vlerës totale të investimit në shumën 86,446,502.00 lekë, ku vlera e investimit nga MAS do të jetë në shumën totale 69,157,202.00 lekë, për vitin 2026 shuma e investimit do jetë 42,662,880.00 lekë dhe për vitin 2027 shuma e investimit do të jetë 26,494,322.00 lekë dhe bashkëfinancimi nga Bashkia Lushnjë për vitet 2026 dhe 2027 është në vlerën totale 17,289,300.00 lekë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria Juridike dhe Prokurorimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE	DREJTORIA E FINANCËS	DREJTORIA E PLANIFIKIMIT
Bedri Hida	Ervisa Çuko	Ariola Beqo

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com